



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 45/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, për shkak të mbajtjes së fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për fushatë zgjedhore për zgjedhjet jashtëzakonshme lokale për kryetar komune në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 20.04.2012, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë ankesa si e palejuar.

### Arsyetim

Me datë 17.04.2012, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV dega në Ferizaj, më të cilën thekson se me datën 14.04.2012 në faqen zyrtare të Agim Aliut kandidat nga rradhët e PDK-se janë ekspozuar foto në të cilat vërehet qartë fillimi i fushatës elektorale nga ky subjekt politik. Poashtu në ankesë më tutje theksohet se në këtë faqe shihet vizita e kryeministrit Hashim Thaçi si dhe thirrja tek qytetarët për të votuar subjektin e tij politik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik PDK ka bërë shkeljen e LQP dhe Kodin e Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet, duke e filluar fushatën zgjedhore para datës së përcaktuar nga KQZ-ja.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë materiale disa foto nga zhvillimi i kësaj ngjarje.

Neni 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LQP), Rregulla Zgjedhore nr. 11/2009, Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009 Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, siç del nga të gjitha dispozita ligjore dhe Rregullat Zgjedhore të lartcekura, ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësit e tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

PZAP-i nga shkresat e lëndës gjeti se:

**ankesa është e palejuar**

Duke pasur parasysh se dispozitat e lartcekura ligjore përcaktojnë të drejtat e subjekteve politike si dhe veprimet e ndaluara të tyre vetëm gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, dhe meqenëse se veprimet e pretenduara janë zhvilluar para datës zyrtare të përcaktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, si dhe duke u bazuar në atë se me asnjë dispozitë të paraparë të LZP-së dhe as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ndëshkimore ligjore për mbajtjen e fushatës zgjedhore para datës së përcaktuar për mbajtjen e saj.

Në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 45/2012 më datën 20.04.2012.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

